Zoti Kryetar i Bashkisë,

Zoti Drejtor,

Zonja dhe Zotërinj,

Gazetarë të nderuar,

Eshtë e para herë për këtë vit që po shprehem publikisht dhe do të dëshiroja fillimisht t'i shprehja urimet më të mira për vitin 2013, Kryetarit të Bashkisë dhe ekipit të tij, qytetarëve të Tiranës, si dhe shtypit, i cili është shumë i rëndësishëm për demokracinë.

Jam e lumtur se po fillojmë vitin e ri me një bashkëpunim të ri dhe të rëndësishëm midis Bashkisë së Tiranës dhe qeverisë franceze.

Me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, qeveria franceze pranoi të financojë : "Studimin e fizibilitetit dhe projektin paraprak të një linjë trami për Tiranën".

Siç edhe e dini, rritja e kapacitetit të transportit publik në një qytet të madh dhe në zgjerim, si Tirana, është një objektiv shumë i rëndësishëm për të lehtësuar qarkullimin, shkëmbimet brenda qytetit dhe konfortin e popullatës. Trami është një zgjidhje e adoptuar me sukses nga shumë qytete në botë, edhe vetë qyteti i Tiranës është angazhuar në këtë drejtim.

Fondi falas i qeverisë franceze, në shumën e 720 000€, i jep mundësi Bashkisë të iniciojë këtë projekt strategjik për zhvillim urban të Tiranës.

Studimi do të realizohet nga EGIS International, një ndërmarrje inxhinierike franceze që punon në infrastrukturat e transportit me shtrirje ndërkombëtare dhe e mirënjohur në Shqipëri: EGIS kontribuon tashmë në zhvillimin e projekteve strategjike në Shqipëri që prej 15 vitesh, në mënyrë të veçantë në rrugë dhe autostrada.

Në këtë projekt të tramit të Tiranës, ekspertët francezë do të operojnë në bashkëpunim të ngushtë me ekipet e Bashkisë. Kompetencat që EGIS do të vendosë në dispozicion të bashkisë, janë të gjëra: ato lidhen me teknologjinë e tramit, ambjentin, hidraulikën, gjeoteknikën dhe llogaritjet ekonomike.

Në praktikë, shërbimet që i janë besuar EGIS do të ndahen në dy faza

- Faza e parë do ti kushtohet realizmit të studimit të fizibilitet teknik, ambjental, dhe financiar të linjës së parë të tramit, Kombinat-Kinostudio.
- Faza e dytë konsiston në përgatitjen e projektit paraprak dhe dosjes së tenderit. Realizimi i kësaj faze të dytë do të kushtëzohet nga shprehja e interesit të institucioneve financiare për financimin e ndërtimit të linjës së parë të tramit.

Bëhet fjalë pra për një ndihmë shumë konkrete, të dhëna nga Franca. Ajo është pjesë e frymës së bashkëpunimit franko-shqiptar dhe ndërmerret për të ndihmuar Shqipërinë të realizojë reformat që ajo ka vendosur.

Në vitin 2011, qeveria Franceze akordoi një fond, të dubluar me asistencë teknike, në mënyrë që të aktualizohen specifikimet teknike në sektorin e tajtimit, transportit dhe shpërndarjes së ujit.

Në të njëjtën mënyrë, duke iu përgjigjur kërkesës së Bashkisë, ne do të sjellim këtë herë një kontibut sa financiar edhe teknik, nëpërmjet EGIS, i cili do të bëjë të mundur të realizohet një hap vendimtar dhe i shpejtë drejt realizimit të linjës së parë, duke e futur këtë projekt në një vizion global, i cili merr parasysh nevojat e të ardhmes, për të shërbyer lagjet e tjera.

Këto fonde ndihmë, tregojnë interesin e qeverisë franceze për të modernizuar pajisjet në dispozicion të popullsisë, të cilat kontribuojnë në progresin e Shqipërisë drejt standarteve evropiane dhe integrimin e saj në Evropë.